VENDIM
Nr. 736, datë 3.12.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 615, DATË 7.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KONTRATAT E TREGTIMIT NË LARGËSI TË SHËRBIMEVE FINANCIARE PËR KONSUMATORËT"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36 e 61, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 615, datë 7.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës "b", të pikës 2, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) "Mjet i komunikimit në largësi" është çdo mjet, që, pa praninë fizike të njëkohshme të tregtarit dhe të konsumatorit, mund të përdoret për lidhjen e kontratës ndërmjet palëve.".

2. Pas pikës 7 shtohet pika 7.1, me këtë përmbajtje:

"7.1 Përjashtimisht sa më sipër, pika 7, e këtij vendimi, lidhur me informimin, nuk aplikohet, me përjashtim të nënndarjeve "iii–vii", të shkronjës "b"; nënndarjeve "i" dhe "iv", të shkronjës "c" dhe nënndarjes "ii", të shkronjës "ç", të kësaj pike, në rastet kur dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi për shërbimet e pagesave gjejnë zbatim.".

3. Në pikën 17, pas fjalës "... përcaktuar", fjalët "... në pikën 3, të nenit 37, të ligjit nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve"..." zëvendësohen me "... në pikën 1, të nenit 37/1, të ligjit nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar."...".

4. Në pikën 18, pas fjalës "... jetës" hiqen fjalët "... sipas përcaktimeve në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve"...".

5. Në pikën 22, pas fjalëve "... të parashikuara në nenet ..." fjalët "...37, pika 4, ..." zëvendësohen me "... 37/7 ...".

6. Pas pikës 24 shtohet pika 24.1, me këtë përmbajtje:

"24.1 Në rastin kur konsumatori heq dorë nga një kontratë sigurimi, tregtari nuk i kërkon konsumatorit të paguajë asnjë shumë.".

7. Shkronja "c", e pikës 33, të këtij vendimi, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Mjetet e tjera të komunikimit në largësi, kur ato lejojnë komunikimet individuale, përveç atyre të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike:

i. nuk do të autorizohen nëse nuk është marrë pëlqimi i konsumatorëve; ose

ii. mund të përdoren vetëm nëse konsumatori nuk ka shprehur kundërshtimin e tij.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me:
Direktivën 2002/65/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 shtator 2002, në lidhje me tregtimin në distancë të shërbimeve financiare të konsumatorëve [numri CELEX 32002L0065, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 271, 9.10.2002, f. 16–24], dhe amenduar nga: direktiva (EU) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25 nëntor 2015 [numri CELEX 32015L2366, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 337/35, 23.12.2015, f. 35–127].